

## KONTRATË THEMELIMI E SHOQËRISË

### “L & E Partners Studio”

Sot më 01/02/2024 Anëtarët Themelues:

1. Leonard Zhupaj, i biri i Mystehak dhe Milika, i datëlindjes 23/07/1978, lindur në Patos dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. Personal H80723142V, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Elmira Zhupaj, e bija e Sali dhe Dallandyshe, e datëlindjes 10.08.1985, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. Personal I55810100L, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

Të dy së bashku, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi, ranë dakort për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “L & E Partners Studio” me kushtet e mëposhtme:

#### NENI 1

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

“L & E Partners Studio” themelohet si shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat 1074-1112 të kodit civil të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është person juridik privat.

Ky akt rregullon pozitën juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

#### NENI 2

#### EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria është person juridik privat.

Emri i shoqërisë së thjeshtë është “L & E Partners Studio” (më poshtë referuar si “shoqëria”).

#### NENI 3

#### SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: TIRANE, Rruga Komuna e Parisit, Zona Kadastrale 8270, Nr.pasurie 8/443-N2, Volumi 80, Faqe 85, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqsimi Brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

#### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- Ofrimin e shërbimeve konsulencë ligjore, shërbime avokatie , duke përfshirë por pa u kufizuar në: Përfaqësim në procese tregtar, penal, civil, familjar, administrative ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto kategori , në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimi në procedurat e ndërmjetësimit ose arbitrazhit.
- Përgatitje të kërkesë padive ose kërkesave për ndjekje penale, përgatitje e kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, të prokurorisë, të arbitrazhit, e të organeve të administratës shtetërore.
- Dhënie ndihme juridike e ndërmjetësime për zgjidhje juridike me mirëkuptim e jashtëgjyqësisht të konflikteve të natyrave të ndryshme.
- Dhënie ndihme juridike për negocimin, hartimin, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, civile, tregtare, administrative dhe për çdo lloj tjetër të veprimeve juridike.
- Ofrim I çdo lloji konsulence te personat fizik dhe juridik, vendas dhe/ose të huaj, publik dhe/ose privatë si shoqëri tregtare, organizma tregtarë qeveritar, organizatat jo fitimprurëse, fondacionet, institucionet shtetërore, ministritë, departamentet qeveritare, dhe autoritetet publike dhe në veçanti konsulencë në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin , marketingun, konsulencë për taksat dhe tatimet, si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore dhe konsulencë e përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektorët e biznesit dhe të industrisë brenda kufizimeve të parashikuara në ligj.
- Vlerësimin e zhvillimit të tregut brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme të informimit për personat juridikë dhe fizikë të interesuar, vendas dhe të huaj, ashtu siç mund të kërkohet prej tyre.
- Konsulencë për administrimin shit/blerjen , dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industrial, publike apo private, duke përfshirë por pa u kufizuar në: ndërmjetësimin për kryerjen e veprimeve të mësipërme midis personave juridik privat apo publik, vendas apo të huaj, dhe personave fizikë , marketing, ekspertizë shitje, menaxhim prone.
- Shërbime kontabiliteti dhe mbajtje pasqyrash financiare e llogarish, regjistrim të dhënash, përfaqësim ligjor .
- Shërbime konsulence ekonomike, financiare, fiskale, juridike për të plotësuar nevojat e bizneseve dhe të menaxhimit , të personave juridik publik/ privat, të shoqërive tregtare dhe të individëve .

- Të kryej studime të ndryshme në fusha me karakter teknik- ekonomik dhe financiar.
- Të organizojë mbajtjen dhe hartimin e pasqyrave financiare për subjekte të ndryshme juridik privat dhe/ose publik, fizik, individë.
- Të organizojë kurse kualifikimi të karakterit profesional në fushën e financës dhe të kontabilitetit.
- Aktivitete të vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, konsulencë teknike në këtë fushë, etj...
- Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose jo me përmbushjen e objektit të sipërpërmendur të shoqërisë.

## NENI 5

### REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin.

Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Me vendim unanim të mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve, shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj, duke bërë dhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

## PJESA II

### NENI 6

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE

Anëtarët themelues kanë këto detyrime:

- Të regjistrojnë shoqërinë pranë QKB-së.
- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin e pandërprerë të personelit ndihmës, të sistentëve, gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.
- Të menaxhojnë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

Anëtarët mbajnë përgjegjësi për humbjen deri në kufirin e kapitalit të investuar.

Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Anëtarëve, në raport me kapitalin themeltar të investuar prej tyre. Pasuritë mund të tjetërsohen, jepen me qira, dhe të lihen peng në hipotekë me miratimin e Mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve.

Anëtarët Themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë shoqërisë duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj, detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 7

### KOMPETENCAT E ANËTARËVE

Anëtarët kanë të drejtat e mëposhtme:

- Të administrojnë aktivitetin e shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj.
- Të administrojnë vlerat e saj intelektuale dhe ekonomike-financiare.
- Të informohen për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj.
- Të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.
- Të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë.
- Të largohen nga shoqëria dhe të shesin pjesën e kapitalit në bashkëpronësi në përputhje me kushtet që lejon statute dhe ligji.

Anëtarët në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi kanë të drejtë që në të njëjtën kohë të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri të tjera tregtare.

Anëtarët kanë të drejtë të paraqesin propozime për shqyrtim para organeve të shoqërisë si dhe të emërojnë/shkarkojnë administratorin, të punësuarit, etj.

## NENI 8

### DETYRIMET E ANËTARËVE

Anëtarët kanë detyrimet e mëposhtme:

- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin e pandërprerë të personelit ndihmës, të asistentëve, gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.



- Të menaxhojë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

#### **NENI 9**

### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 10**

### **KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË**

Aktiviteti operues i shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

#### **NENI 11**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1,0000 (dhjetëmijë) lekë.

Kuotat janë me vlerë nominative. Kapitali përbëhet nga dy kuota.

Dy kuotat e shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

1. Z. Leonard Zhupaj në masën 50 % të vlerës së kapitalit themeltar.
2. Znj. Elmira Zhupaj në masën 50% të vlerës së kapitalit themeltar.

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues me rastin e themelimit të kësaj shoqërie dhe nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi, dhe është nënshkruar prej tyre.

#### **NENI 12**

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Anëtarët mund të transferojnë lirisht kuotat e zotëruara me një marrëveshje me shkrim.

#### **NENI 13**

### **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të të gjithë anëtarëve në përputhje me interesat e shoqërisë.

5

## PJESA IV

### NENI 14

#### ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese janë:

1. Asambleja e Anëtarëve.
2. Administratorët e Shoqërisë.

Mënyra e veprimitarisë së tyre është përcaktuar në këtë statut.

Organi themelor i shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve e cila mund të mbledhet në çdo kohë kur administratori/ët, ose vetë anëtarët e kërkojnë, duke lajmëruar 15 ditë përpara me shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga statuti.

## PJESA V

### NENI 15

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Anëtarët me marrëveshje ne përputhje me nenin 1080 të Kodit Civil bien dakord se:

Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një Administrator i cili do të veprojë i vetëm.

Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e shoqërisë, me qëllim që të arrijnë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon Asamblesë së Anëtarëve.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore, si dhe autorizon në përfaqësim kur është e nevojshme anëtarë të tjerë të shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrative. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të statutit apo për dëme të shkaktuara gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori shkarkohet me vendim të të gjithë anëtarëve për shkaqe të justifikuara.

Personi i mëposhtëm emërohet administrator i shoqërisë për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me të drejtë riemërimi:

Z. Leonard Zhupaj , i biri i Mystehak dhe Milika, i datëlindjes 23/07/1978, lindur në Patos dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal H80723142V

## NENI 16

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto kompetenca kryesore:

- Të miratojë planin e veprimtarisë së shoqërisë, dhe t'i paraqesë sipas rastit për miratim përfundimtar të Asamblesë së Anëtarëve.
- Të parashtojë propozime përkatëse për Asamblenë e Anëtarëve, në lidhje me zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- Të përcaktojë strukturën organizative të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të Asamblesë së Anëtarëve.

## PJESA IV

### VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

#### Neni 17

### VITI FINANCIAR, PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

Viti financiar i shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon ditën e parë të Janarit dhe mbaron ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

Viti i parë financiar i shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

Në fund të çdo viti financiar, administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të shoqërisë dhe strukturën e tyre;
- Përgatitjen e llogarive të fitimit dhe humbjeve.

## NENI 18

### FITIMI I SHOQËRISË



Fitimi neto i shoqërisë shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në shoqëri. Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues. Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

## **PJESA VII**

### **NENI 19**

#### **MBYLLJA E SHOQËRISË, LIKUJDIMI**

Kur vendoset mbyllja e shoqërisë, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve cakton likuidatorin që realizon likuidimin e saj. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit edhe emrin “Shoqëri në likuidim e sipër”. Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

Kur anëtarët pa shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, Likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata përfundimin e likuidimit.

Aktet e përfundimit të likuidimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në QKB për çregjistrimin e shoqërisë.

## **PJESA VIII**

### **NENI 20**

#### **TË PËRGGJITHSHME**

Mosmarrëveshjet për statutin dhe kontratën e themelimit të shoqërisë do të zgjidhen nga vetë anëtarët me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut do të hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje.

## **ANËTARËT**

**Leonard Zhupaj**



**Elmira Zhupaj**

